



# Procesi i integrimit të shoqërisë civile dhe Shqipërisë në BE

RAPORT PËRMBLEDHËS





**Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.**

**©Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim  
TIRANË, SHQIPËRI**

**Përgatitur nga:**

**Gentiola Madhi  
Ramadan Sopot**

## Një vlerësim i dyanshëm i kapaciteteve të OSHCve dhe gadishmërisë së institucioneve për përfshirjen e tyre në këtë proces

Deri në vitin 2020, kanë kaluar gjashtë vite që kur Shqipërisë iu dha statusi i kandidatit dhe në 25 Mars të këtij viti, vendet anëtare të BE morën një vendim konsensual në mbledhjen e Këshillit mbi fillimin e bisedimeve të pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut[1]. Kjo është faza e fundit e procesit të gjatë të integrimit të Shqipërisë, qëllimi i së cilës është arritja e një pajtueshmërie të gjerë dhe të qëndrueshme me normat dhe standardet e BE-së.

Bashkëpunimi efektiv midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në procesin e integrimit evropian është i rëndësishëm për krijimin e institucioneve të shëndosha e të mirëqeverisura dhe për të përmirësuar procesin e politikëbërjes. Shqipëria po krijon një kornizë ligjore, strategjike dhe institucionale për të mbështetur pjesëmarrjen e OSHC-ve në procesin e vendimmarrjes. Sidoqoftë, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar ende në mënyrë efektive.

Një nga detyrat më sfiduese përpara pranimit të Shqipërisë është krijimi i një procesi të hartuar mirë të politikës, bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së aktorëve **jo-shtetërorë**. Në veçanti, OSHC-të duhet të futen në proces me ekspertizën dhe kapacitetin e tyre monitorues.

OSHC-të shpesh nuk marrin pjesë aktive në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) ose kontribuojnë në to. Roli i tyre mjaft pasiv vjen edhe për shkak të reagimeve të parregullta nga autoritetet kombëtare dhe neglizhenca e kontributit të OSHC-ve, një mungesë e përgjithshme e transparencës, një mungesë besimi në platformat e vendosura për pjesëmarrjen e OSHC-ve dhe një mungesë e perceptuar e ekspertizës në fusha të caktuara. Një çështje shtesë për t'u adresuar është informacioni joadekuat i ofruar për qytetarët, për të cilin janë përgjegjës autoritetet kombëtare dhe OSHC-të.

Duke u bazuar në problemet e njohura dhe përvojën e vendeve të tjera, kjo përmbledhje jep shkurtimisht rekomandime se si të shfrytëzohen negociatat e pranimit për të përmirësuar bashkëpunimin midis aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, dhe se si ato mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e politikëbërjes dhe praktikave demokratike.

[1] Council of the European Union, Council conclusions on enlargement and stabilisation and association process, ELARG 20, COWEB 35, 7002/20, Brussels, 25 March 2020, p. 4, accessible at: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

## Integrimi evropian dhe roli i shoqërisë civile në procesin e negociatave

- BE është në mbështetje të shoqërisë civile në vendet kandidate gjatë periudhës së para-anëtarësimit. Në mbështetje të zhvillimit të një shoqërie civile aktive, BE i koncepton këto organizata si aktorë që do të ndihmojnë vendet kandidate për të përmbushur kërkesat e kushteve politike siç janë dinjiteti njerëzor, liria, barazia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut.
- Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e para-anëtarësimit vlerësohet si një mjet **"për të informuar dhe ndërgjegjësuar qytetarët"** për të kuptuar reformat që një vend duhet të kryejë në mënyrë që të kualifikohet për anëtarësimin në BE.
- Në mënyrë që procesi dypalësh i bashkëpunimit në kuadër të negociatave për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian të funksionojë, duhet që fillimisht **palët të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e tyre në këtë proces**. Më shumë se gjysma (57.7%) e tyre deklarojnë se është shumë i rëndësishëm, dhe 35.6% e tyre e vlerësojnë të rëndësishëm.
- Ka disa mënyra në të cilat shoqëria civile mund të kontribuojë në procesin e integritit të vendit në BE, dhe gatishmëria e OShC-ve për të kontribuar raportohet në nivele shumë të larta. 89.4% e OShC-ve deklarojnë se do të ishin të interesuar të **angazhoheshin aktivisht në procesin e integritit** nëse u jepet mundësia, ndërsa vetëm 1% e tyre deklarojnë se nuk janë të interesuar.
- Pavarësisht gadishmërisë së këtyre organizatave për të kontribuar, niveli i njohurive të tyre në lidhje me këtë proces **mbetet një pengesë**. Vetëm 22.1% e OShC-ve raportojnë se kanë njohuri shumë të mira për procesin e anëtarësimit, dhe 42.3% e tyre raportojnë se kanë njohuri të mira.
- OShC-të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Ata **përfaqësohen si partner dhe kontribues në agjendën e BE-së**, si dhe zbatues të fortë të politikave dhe strategjive kryesore. 58.7% e OShC-ve deklarojnë se ata e perceptojnë rolin e tyre në informimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me procesin e integritit, dhe 28.8% në sigurimin e ekspertizës sipas fushës përkatëse të ekspertizës.
- Vetëm 9.6% e OShC-ve deklarojnë se i njohin shumë mirë skemat e financimit të BE-së, 26.9% deklarojnë se i njohin mirë dhe 42.3% e tyre deklarojnë se i njohin disi. Kjo shkallë e ulët e njohurive në lidhje me skemat e financimit të BE-së ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe për këtë arsye ngritja e kapaciteteve të këtyre organizatave për të aksesuar këto fonde nga këto skema financimi vazhdon të jetë i rëndësishëm.

## Aksesi në informacion

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është koordinatore e procesit të Integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe për rrjedhojë duhet të bashkërendojë dhe të udhëheqë procesin me të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse të akorduara sipas kapitujve.

Platforma e Partneritetit të Integritimit Evropian, përcakton 14 Institucione përgjegjëse për të udhëhequr procesin e konsultimit sipas kapitujve respektivë. Sipas një monitorimi të vazhdueshëm të njoftimeve për shprehje interesi për pjesëmarrje në Platformën e Partneritetit të Integritimit Evropian, vihen re një sërë problematikash:

### **1. Mungesa e një standardi në mënyrën e publikimit të njoftimeve për shprehje interesi**

Vendosja dhe ruajtja e një standardi për procedurat e publikimit të njoftimeve lehtëson procesin e përcjelljes së mesazhit nga institucionet tek e gjithë audience e interesuar. Është konstatuar se institucionet nuk kanë një plan komunikimi të qartë të miratuar i cili presupozohet të përcaktojë rregullat e publikimit të këtyre thirrjeve. Institucionet kanë zgjedhur t'i publikojnë në faqet e tyre zyrtare duke i përfshirë në rubrika të tjera duke vështirësuar gjetjen e njoftimeve për organizatat/individët e interesuar për të marrë pjesë në këto tryeza. Pra praktikisht organizatat/individët duhet të jenë të mirëinformuar në lidhje me procesin në mënyrë që të kenë mundësi të ndjekin këto njoftime.

### **2. Mungesa e respektimit të kohëzgjatjes së thirrjeve për shprehje interesi**

Afati i vënë në dispozicion në thirrjet për shprehje interesi është i rëndësishëm pasi në veteve shfaq integritetin e të gjithë procesit duke i dhënë mjaftueshëm kohë të gjithë palëve të interesuara kohën e mjaftueshme për të vlerësuar pozicionin e tyre në raport me thirrjen.

Nga monitorimi rezulton që mungon gjithashtu një standardizim i afateve të lëna në dispozicion për të interesuarit për të shprehur interesin e tyre për të marrë pjesë në këto tryeza. Në disa prej rasteve, institucionet kanë parashikuar në thirrje një afat prej 5 ditësh që është thujse i pamundur për organizatat/individët për ta konsideruar si thirrje. Duke i shtuar kësaj dhe faktin që nuk respektohen gjithashtu standardet e publikimit e bën “kapjen” e këtyre thirrjeve një mision të pamundur. Nga ana tjetër, ka institucione të cilat kanë parashikuar një afat 30-ditor i cili konsiderohet mëse i mjaftueshëm. Kjo mund të vijë si rezultat i mosrespektimit të afateve kohore nga ana e institucioneve, të cilat pasi kalojnë afatet e tyre për shpalljen, shkurtojnë afatet kohore të thirrjes.

### **3. Mungesa e promovimit nga institucionet**

Institucionet duhet të jenë më proaktive në promovimin e thirrjeve të tilla dhe duhet të shfrytëzojnë çdo medium të mundshëm për t'i dhënë zë këtyre ngjarjeve dhe për të siguruar një mbulim të mjaftueshëm. Kjo nuk është realizuar pothuajse nga asnjë nga institucionet përgjegjëse përfshirë vetë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), vetëm në rastin e Ministrisë së Drejtësisë mund të themi që ka bërë një punë të mirë duke i dhënë zë procesit në shumë mënyra të ndryshme.

Prandaj, MEPJ duhet të forcojë rolin e saj si “Udhëheqës” në këtë proces dhe të detyrojë e monitorojë ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim respektimin e standardeve kohore, mënyrat e publikimit dhe gjithashtu promovimin e thirrjeve.

Pavarësisht ekzistencës së një plani komunikimi për të siguruar mbulimin me informacion adekuat të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces, prezenca e një plani të tillë pothuajse nuk është ndjerë fare.

- 55.8% e OShC-ve deklarojnë se nuk janë në dijeni të një strategjie komunikimi nga qeveria shqiptare për procesin e integritit të Shqipërisë në BE, ndërsa 29.8% e tyre deklaruan se ekziston një strategji komunikimi. Një shkallë shumë e lartë nuk kishte informacion, i cili sjell edhe një herë në vëmendje mungesën e promovimit të procesit nga institucionet.
- **Vetëm 15.4%** e vlerësuan zbatimin e strategjisë së komunikimit të qeverisë si pjesë e procesit të integritit në BE si shumë të kënaqshme ose të kënaqshme, dhe 36.5% e tyre e vlerësuan atë si disi të kënaqshme. Nga ana tjetër, **47.7%** e vlerësuan atë si të pakënaqshme ose aspak të kënaqshme, duke theksuar edhe një herë performancën e ulët të institucioneve.
- Të pyetur në lidhje me **rolin që organizatat mund të luajnë në promovimin e zbatimit të strategjisë së komunikimit**, 50% e organizatave u përgjigjën duke pranuar se ata vetë duhet të ishin më kërkues ndaj institucioneve duke bërë presion që kjo strategji të zbatohet, dhe 40.4% pranojnë që ato të jetë proaktiv në ndarjen e informacionit midis organizatave, në një farë mënyre duke shprehur një autokritikë të caktuar në lidhje me këtë aspekt.

Zhvillimet e çështjeve të integritit të Shqipërisë në BE kanë qenë dinamike për vetë faktin se si kanë rrjedhur ngjarjet vitet e fundit. Me vendimin e Këshillit Evropian për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE, me qëllim progresin e të gjithë procesit kërkohet një komunikim akoma më i mirë midis të gjitha palëve. Për të patur një kuptim më të mirë të performancës së administratës publike në aspektin e shpërndarjes së informacionit u është kërkuar të intervistuarve të japin vlerësimin e tyre krahasuar me një vit më parë.

- 52.9% e OShC-ve deklarojnë se situata nuk ka ndryshuar, 25% e tyre deklaruan se niveli i mbulimit të informacionit është përmirësuar disi në krahasim me një vit më parë, një shifër që tregon një *përmirësim të dukshëm në terma sasiorë*

Një ndër shqetësimet më të mëdha të ngritura nga intervistuesit është mungesa e zbatimit të një plani efektiv komunikimi i cili do të përmirësonte ndjeshëm efikasitetin e gjithë këtij. Vihet re nga anketimi që institucionet qeveritare nuk kanë zbatuar një plan efektiv komunikimi, i cili në vetevete duhet të jetë i zbërthyer në aktivitete, mjete komunikimi dhe masa të cilat sjellin rezultate positive.

- Në 64.4% të rasteve konstatohet se institucionet përkatëse informojnë organizatat drejtpërdrejt me email për progresin e procesit dhe njoftimet përkatëse. Kjo metodë e komunikimit është e njohur mirë nga institucionet por mbart shumë kufizime pasi këto njoftime u dërgohen vetëm atyre organizatave që punojnë në mënyrë aktive me institucionet dhe gjenden në bazën e të dhënave, duke lënë jashtë një numër të madh të organizatave. Në vendin e dytë është faqja në internet e institucionit dhe llogaritë e institucioneve në rrjetet sociale me 63.5% të rasteve.

## Roli i administratës publike në përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e integritit evropian

Duke marrë parasysh faktin se negociatat e pranimit janë një fazë thelbësore e procesit të pranimit, është me rëndësi të madhe që shoqëria civile të përfshihet në mënyrë aktive. Për zyrtarët e BE-së, organizatat e shoqërisë civile përfaqësojnë një burim të rëndësishëm dhe të pavarur informacioni dhe rekomandimesh, ndërsa ato gjithashtu mund të sigurojnë mbikëqyrje të zonave specifike të vendit politikisht sfidues (Drakić & Kajganović, 2012). Nga ana tjetër, BE siguron një efektivitet më të madh dhe legjitimitet të procesit të pranimit në BE përmes përfshirjes së grupeve të interesit vendas (Tanja, Buzogany, & Guttenbrunner, 2008). Për më tepër, procesi i pranimit në BE ka vetëformuar përfaqësimin dhe advokimin e grupeve të interesit vendas. Gjatë periudhës së para-anëtarësimit, BE fuqizon aktorët joshitetërorë përmes stimujve të tij të veçantë të ndihmës financiare, reformave të politikave të shkaktuara nga BE dhe rrjeteve transnacionale të BE-së, duke i hapur rrugën përfshirjes së aktorëve të vendosur në qeverisjen shumëplanëshe (Dorian Jano, 2015).

- Në mënyrë që marrëdhënia midis palëve të jetë e frytshme dhe produktive, fillimisht të dyja palët duhet të kenë një kuptim të qartë të rolit të gjithësecilit në këtë proces dhe të këtë një pranueshmëri të gjerë për këtë. Të pyetur në lidhje me njohjen e rolit të shoqërisë civile nga administrata publike, pjesa dërrmuese **83.7%** e vlerëson shumë dobët ose dobët. Është për t'u theksuar që *asnjë nga organizatat nuk e vlerëson me shumë mirë punën e administratës publike*, dhe tregon që këto shifra janë këmbana për administratën publike për të marrë masa me qëllim zhvillimin e proceseve konsultuese gjithëpërshirëse.

Administrata publike ka ndërmarrë një sërë politikash për të çuar përpara procesin e negociatave të Shqipërisë në kuadrin e integritit në BE.

- *75% e OShC-ve vlerësojnë përshtatshmërinë e këtyre politikave të ndërmarrë nga qeveria si shumë të dobëta ose të dobëta, ndërsa 25% e tyre e vlerësojnë atë si shumë të mirë ose të mirë.*
- Një nga pengesat më të mëdha të raportuara nga shoqëria civile në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh qeveri-shoqëri civile, jo vetëm në procesin e integritit evropian por në të gjitha proceset konsultative është disponueshmëria dhe angazhimi i stafit administrativ ndaj shoqërisë civile. Të pyetur për këtë fakt, 59.6% e OShC-ve e vlerësojnë atë si shumë të dobët ose të dobët ndërsa 40.4% të tyre e vlerësojnë atë si shumë të mirë ose të mirë. *Ky është një tregues që ka shënuar një përmirësim, por përsëri duhet një përpjekje më e madhe.*

Proceset konsultuese të çfarëdolloj natyre kërkojnë përkushtim nga ana e administratës publike dhe rrjedhimisht stafi i dedikuar për këto pozicione është i domosdoshëm për ti realizuar këto procese në mënyrë efektive. Mungesa e stafit të dedikuar në administratën publike është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e dobët të performancës së tyre, por duhet të theksojmë faktin që konsultimi publik si proces në tërësi ka performancë të ulët në Shqipëri.

Megjithëse angazhimi i shoqërisë civile është kritik, shumica e organizatave kanë vështirësi në kuptimin e rolit të tyre si dhe kapacitete të dobëta dhe mungesë burimesh për të dhënë ndikim të rëndësishëm. Duke i shtuar dhe faktin e punës së dobët të administratës në promovimin e rolit të OShC-ve deri në eklipsimin e tyre në këto procese çka shkakton një ulje të efektivitetit të tyre në proces.



- Kur u pyetën për nivelin e promovimit të pjesëmarrjes së OSHC-ve në proceset e konsultimit, 67.3% e vlerësojnë atë si shumë të dobët ose të dobët dhe vetëm 32.7% e vlerësojnë atë si të mire.
- Sipas përfaqësuesve të OSHC-ve, *institucionet publike kanë tendencë të ofrojnë informacione të përgjithshme sesa dokumente që mund të zbulojnë informacione që konsiderohen potencialisht të ndjeshme nga institucionet publike.*
- *Mungesa e vullnetit politik për të kryer procese të mirëfillta konsultimi dhe për të përmirësuar bashkëpunimin midis OSHC-ve dhe institucioneve është e dukshme. Institucionet shtetërore nuk e konsiderojnë angazhimin me OShC-të si një instrument për përparimin e interesit publik, por më tepër si një ngarkesë shtesë pune pa ndonjë ndikim të rëndësishëm.* Prandaj, kjo rrit mosbesimin e ndërsjellë midis institucioneve publike dhe OSHC-ve në lidhje me bashkëpunimin e tyre.
- Pjesa më e madhe e ndërveprimit midis dy entiteteve pengohet nga kultura e kufizuar transformuese brenda institucioneve shtetërore. Institucionet nuk investojnë burime dhe energji të mjaftueshme në ndërtimin e kapaciteteve, trajnimin e stafit dhe promovimin e vlerës në procesin e bashkëpunimit të tyre me OSHC-të.
- Për të vlerësuar rolin e qeverisë shqiptare në angazhimin e OShC-ve në procesin e integritit, të anketuarve iu kërkua të siguronin një vlerësim të 3 viteve të fundit që përkojnë me mandatin e qeverisë 2017-2021. Në 14.4% të rasteve vlerësuan se roli i qeverisë ka qenë pozitiv gjatë 3 viteve të fundit, por nga ana tjetër 49% e tyre vlerësuan se roli i qeverisë ka qenë negativ. Ekziston një shkallë e lartë (38.5%) e tyre që vlerësuan rolin e qeverisë si neutral.

## Efiçenca e procedurave të administratës në kuadër të organizmit të proceseve konsultuese

Me qëllim avancimin e negociatave të Shqipërisë për integrimin evropian nevojitet një bashkëpunim dhe bashkërendim më i ngushtë në të gjitha nivelet e qeverisë me platformat parlamentare dhe ato të shoqërisë civile në lidhje me çështjet e integritit evropian.

Roli dhe kontributi i OSHC-ve konsiderohet pjesë jetësore e procesit të negocimit të anëtarësimit në BE, veçanërisht sa i përket rolit të tyre në përfaqësimin e zërit të qytetarëve dhe në mbështetjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve të Shqipërisë në lidhje me ndikimin e integritit në BE në jetën e tyre.

- Të pyetur në lidhje perceptimin e tyre në lidhje me performancën e institucioneve publike në udhëheqjen e proceseve të konsultimit, vetëm rreth **5%** e tyre deklarojnë se *ka bërë një punë të mirë*, **37.5%** e tyre deklarojnë se ka punuar por *mund të kishte bërë një punë më të mirë* ndërkohë që pjesa dërrmuese (**49%**) mendon se *nuk ka bërë një punë aspak të mirë* në udhëheqjen e këtyre proceseve.
- Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë patur dijeni për konsultimet që janë kryer nga institucionet shtetërore në kuadër të grupeve ndërinstucionale të punës (GNP). Më shumë se gjysma (58.7%) deklarojnë se janë në dijeni dhe 41.3% e tyre nuk kane aspak informacion.
- Vetëm 47% e atyre që kanë qenë në dijeni kanë aplikuar për të qenë pjesë, dhe prej tyre 16% e atyre që kanë aplikuar është pranuar për të marrë pjesë. Nga ana tjetër, 53% e të intervistuarve deklarojnë se kanë qenë në dijeni por nuk kanë aplikuar për të marrë pjesë. *Ky është një tregues i qartë i mungesës së besimit të OSHC-ve në proceset përzgjedhëse nga ana e institucioneve.*

## Marrëdhënia institucionale OSHC-Administratë në proceset konsultuese

Ministria e re për Evropën dhe Punët e Jashtme, e krijuar pas zgjedhjeve të qershorit të 2017-ës është ministria e linjës përgjegjëse për garantimin e forcimit institucional të këtij bashkëpunimi.

Institucionalizimi i bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile kërkon që të gjitha ministritë e përfaqësuar në Këshill të sigurojnë qarkullimin e duhur të informacionit, ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës së Këshillit, si dhe përfshirjen e anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit në procesin e vazhdueshëm të diskutimeve të grupeve ndërminstrore të punës. Ky është parakushti për të gjithë anëtarët e Këshillit në ushtrimin e mandatit të tyre siç parashikohet në ligj.

- Koordinimi i administratës publike me shoqërinë civile në pjesën dërrmuese **(75%)** të rasteve, konsiderohet si *shumë dobët ose dobët*, e mbështetur nga gjithë gjetjet e studimit si dhe nga intervistat e realizuara me ekspertët. Ndërkohë vetëm **25%** e të intervistuarve e konsiderojnë si *shumë mire ose mirë* punën e bërë nga administrata në koordinim me shoqërinë civile.
- *Ofrimi dhe ndarja e informacionit në kohën e duhur* për t'ju dhënë kohë të gjitha palëve të interesuar për të vlerësuar pozitat e tyre është thelbësore për të gjitha proceset konsultuese dhe kjo vetëm tek ato të integritimit Evropian. Administrata vijon të mbetet e ngurtë në këtë aspekt dhe shpesh herë kjo “traditë” ka çuar në atë çka quhet “plotësimi i kutisë”, pra administrata shkëmben informacion për proceset e ardhshme jo në kohën e duhur vetëm për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe jo se e shohin të frytshëm bashkëpunimin.
- *Të pyetur nëse administrata publike ka ofruar informacione në kohë* për hapat e ardhshme të proceseve konsultuese, në **73%** të rasteve kjo vlerësohet negativisht. Të intervistuarit deklarojnë se e marrin informacionin në rrugë joformale më shumë se në ato formale. Nga ana tjetër ekziston një grup organizatash **(27%)** që e vlerëson pozitivisht administratën dhe mendon se ka bërë një punë të mirë në këtë aspekt.

Proceset konsultuese të ngritura në kuadër të negociatave për aderimin në BE, janë të mirëpërcaktuara nga ana metodike dhe janë të “ngurta” në aspektin e mënyrës se si do të zhvillohen. Megjithatë, nevoja për të patur disponueshmërinë dhe cilësinë e informacionit në ato momente kur është e nevojshme mbetet një detyrim.

- Organizatat të cilat kanë marrë pjesë në studim janë pyetur në lidhje me disponueshmërinë dhe cilësinë e informacionit që u është vënë në dispozicion atyre në lidhje me proceset konsultuese dhe në **61.5%** vlerësohet *shumë dobët ose dobët*. Nga ana tjetër **39.5%** e atyre që kanë bashkëpunuar me administratën, e vlerësojnë pozitivisht dhe deklarojnë se kanë marrë informacione cilësore.

Organizatave pjesëmarrëse në studim janë pyetur në lidhje me sugjerimet e tyre që do të donin t'i drejtonin administratës publike në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të proceseve konsultuese në kuadër të negociatave për aderimin në BE. Pjesa më e madhe e tyre njëzëri kërkon përfshirje më të madhe të OSHC-ve dhe njohjen e rolit të tyre në këtë proces në mënyrë që edhe sektori të jetë një motor shtytës i këtij procesi. Gjithashtu disponibiliteti dhe cilësia e informacionit të nevojshëm për të gjitha grupet e interesuara është një detyrim i cili kërkohet me forcë nga ata si një e drejtë të cilën ua parashikon dhe ligji. Së treti, mbi të gjitha kërkohet transparencë në vendimarrjet e administratës dhe artikulli i qartë i vendimeve të marra. Së katërti, sugjerohet ngritja e kapaciteteve të stafit të administratës shtetërore e cila është përgjegjëse për organizimin e proceseve konsultuese në mënyrë që të realizojnë detyrat e tyre të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe e kanë për detyrim ti zbatojnë. Së fundmi, organizatat e reja kërkojnë që të kontribuojnë dhe pretendojnë që edhe atyre u duhet dhënë medium për të marrë pjesë në këto procese dhe pavarësisht eksperiencës së tyre si organizata.

## Nevojat e brendshme të organizatave për të kontribuar në proceset konsultuese

Kontributi i shoqërisë civile në proceset konsultuese të integritit evropian është i pranuar gjerësisht nga të gjitha palët e përfshira. Niveli i përfshirjes të të gjitha palëve në këtë proces dhe shkaqet vlejné të shtrohen për diskutim. Ashtu siç rezulton nga studimi dhe është elaboruar më sipër, një pjesë e mirë e organizatave nuk kanë aplikuar duke shprehur interesin për të kontribuar në tryezat e diskutimit. Ekziston një pjesë tjetër e cila ka aplikuar dhe mendon se është penalizuar pasi nuk është pranuar që të jetë në strukturat konsultuese. Ky shqetësim duhet trajtuar në të dyja kahet: së pari procesi integriteti i procesit duke filluar nga vullneti politik, mekanizmat e përdorur dhe transparenca e vendimeve të marra nga institucioni publik përgjegjës dhe së dyti, kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të kontribuar në këto tryeza. Aspekti i parë është trajtuar më lart ndaj tek ky seksion do ndalemi vetëm në aspektin e dytë.

Të pyetur në lidhje me nevojat e brendshme të organizatave në mënyrë që ato të jenë në gjendje të aplikojnë në këto procese konsultuese, të intervistuarit kanë listuar çështjet e mëposhtme si më të rëndësishmet.

1. **Rritje e kapaciteteve mbi procesin e integritit** sipas fokusit të punës dhe rolin e OSHC-ve në këtë proces.
2. **Rrjetëzimi dhe identifikimi në një platformë unike të OSHC-ve** sipas fushave të tyre të ekspertizës. Në këtë mënyrë edhe institucionet shtetërore do ta kishin më të thjeshtë identifikimin dhe bashkëpunimin me OSHC-të përkatëse.
3. **Njohja me programet e politikave të BE-së dhe rolin e OSHC-ve** në përmbushjen e detyrave të lëna për Shqipërinë.

Megjithëse zbatimi dhe praktika e Shqipërisë në proceset negociuese janë të pakta, korniza ligjore në Shqipëri siguron hapësirë për bashkëpunim për nismat e shoqërisë civile dhe bashkëpunim me autoritetet publike në procesin e pranimit në BE. Bashkëpunimi i përgjithshëm me OSHC-të në procesin e bisedimeve vlerësohet pozitivisht nga institucionet publike, ndaj autoritetet janë përqëndruar në një qasje të thjeshtuar të pjesëmarrjes së shoqërisë civile. Gjithësesi, përfshirja e OSHC-ve në proceset e konsultuese duhet të arrihet, pavarësisht faktit nëse Shqipëria do të anëtarësohet në BE apo jo. Gjithashtu, njohja reciproke, solidariteti më i madh dhe mobilizimi i vazhdueshëm i OSHC-ve dhe platformave të tyre rreth temave dhe vlerave të përbashkëta është e nevojshme për të bashkuar kapacitetet dhe burimet dhe për të arritur një ndikim më të mirë në procesin e vendimmarrjes.

## Për OSHC-të

- **Një angazhim më proaktiv** i OSHC-ve është i nevojshëm për të marrë pjesë plotësisht në procesin e integritimit në BE dhe kjo fillon me njohjen mirë të procesit. Kjo do të thotë që OSHC-të duhet të përqendrohen në zhvillimin e analizave në kohë të çështjeve të mbuluara nga kapitujt e bisedimeve; **të mbrojnë në mënyrë aktive rekomandimet e bëra** në bazë të analizave të tyre; **të përfshihen në krijimin e inputeve të rregullta** për raportet e përparimit të KE-së, qoftë individualisht, qoftë përmes ndonjë lloj rrjeti të shoqërisë civile; dhe **të marrin pjesë aktive në takime** me zyrtarët qeveritarë, si dhe në seancat e komisioneve parlamentare.
- OSHC-të duhet **të përdorin plotësisht kornizën ekzistuese ligjore për pjesëmarrje**, si dhe instrumentet ligjore për qasje në drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave të qytetarëve.
- OSHC-të duhet **të forcohen dhe të organizohen më mirë** për të monitoruar procesin e pranimit në BE. Përmes një organizimi të tillë, do të ofrohet ekspertizë përkatëse për çështje të caktuara dhe do të krijohet përgjigje adekuate për çështje të caktuara në lidhje me procesin e pranimit në BE në axhendën e politikave.
- OSHC-të dhe platformat e tyre duhet **të ndajnë të gjithë informacionin përkatës - me shoqërinë civile në përgjithësi**, si dhe me publikun. Zëri i bashkësive lokale, veçanërisht përmes angazhimit të mëtejshëm të OSHC-ve aktive në nivelin lokal, duhet të përdoret më shpesh. Palët e interesuara do të kenë informacionin e nevojshëm për procesin dhe angazhimin e tyre të mundshëm në të.

## Për institucionet publike

- **Realizimi i konsultimeve të rregullta** dhe në kohë të institucioneve publike me OSHC-të në procesin e pranimin të Shqipërisë në BE, në faza të ndryshme të procesit.
- Strukturat drejtuese të bisedimeve duhet t'i shprehin qartë OShC-ve se **çfarë të dhënash dhe çfarë lloj analize u nevojitet**. Kështu që, mund të arrihet pjesëmarrje konkrete më e mire e OSHC-ve dhe të jepet përgjigje dhe kontribut real.
- **Dokumentet dhe informacionet përkatëse gjatë procesit të negociatave duhet të vihen në dispozicion të publikut**, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të paraqesin sugjerime, komente dhe rekomandime dhe të monitorojnë procesin. Procesi duhet të mbahet transparent, me të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse, pas procesit të bisedimeve, të vëna në dispozicion të publikut menjëherë.
- **Krijimi i një hapësirë zyrtare online kushtuar procesit të pranimin të Shqipërisë në BE**. Një faqe e tillë në internet mund të përmbajë dokumente të publikuara të negociatave të pranimin dhe të mundësojë sistematizimin, azhurnimet e rregullta dhe informacionin e duhur.
- **Krijimi i një mjedisi mbështetës për qendrueshmërinë e OSHC-ve**. Nga raportet është e qartë se arsyeja e hendekut midis teorisë dhe praktikës së partneritetit është mungesa e strukturave brenda qeverisë.

